



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 1401 Prot.

Tiranë, më 18.07.2017

V E N D I M

Nr.167, datë 18/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 75, datë 29.06.2016, "Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 426/1 prot., datë 02.06.2016", në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 75, datë 29.06.2016, "Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 426/1 prot., datë 02.06.2016", në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,

Vërejtje:

Në zbatim të urdhrin nr. 426/1 prot., datë 02.06.2016, "Për verifikimin e informacionit të ardhur nga një nëpunës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me parregullsi të pretenduara gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore", ka filluar hetimi administrativ për rastin e nëpunësit *****. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 75, datë 29.06.2016, "Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhërin e verifikimit nr. 426/1 prot., datë 02.06.2016", në të cilin është vendosur:

"1. Të konstatojë të paligjshëm aktin administrativ Vendimin nr. 363, datë 30.05.2016, të Komisionit Disiplinor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, referuar nenit 109 pika "d" të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative" pasi është një akt i cili vjen në kundërshtim me një dispozitë të ligjit material.

2. Për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të drejtojnë procesin e anulimit të tërësishëm të aktit administrativ, Vendimit nr. 363, datë 30.05.2016, të Komisionit të Disiplinës së DPT, prej organit që e ka nxjerrë aktin.

3. Të merren masat e duhura administrative që të rregullohen pasojat e ardhura nga ky akt i paligjshëm, duke e kthyer nëpunësin ***** në pozicionin e mëparshëm "Përgjegjës në Sektorin e Pajisjeve Fiskale në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit" pranë Drejtorisë

së Përgjithshme të Tatimeve dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë.

4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë nga marrja dijani për këtë vendim.”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 75, datë 29.06.2016, me Urdhrin Nr. 165/1 prot., datë 16.05.2017, *“Për verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 75, datë 29.06.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka filluar verifikimin e zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 18.05.2017, u paraqitën në insitucion. Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 165/2 prot., datë 16.05.2017, *“Njoftim për fillimin e verifikimit”*.

Grupi i punës, gjatë vizitës në institucion komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetonin zbatimin e pjesshëm të detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin paralajmërues. Dokumentacioni shoqëruar që administrohej nga kjo zyrë dhe zyra e Arkiv-Protokollit, është materializuar në procesverbalin e datës 18.05.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe personi i kontaktit të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Nga njësia përgjegjëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në datën 14.07.2017 është vënë në dispozicion të grupi të punës dokumentacioni i nevojshëm për përmbylljen e zbatimit të Vendimit Nr. 75, datë 29.06.2016, dërguar në rrugë elektronike.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

Nëpunësi ***** i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt: *“Shfuqizimin e vendimit nr. 363, datë 30.05.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit *****; Detyrimin e palës së paditur (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve), për të rikthyer në punë paditësin ***** në Pozicionin e Përgjegjës në Sektorin e Pajisjeve Fiskale në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë; Detyrimin e palës së paditur për të paguar paditësin nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare 30.05.2016 deri në ditën e ekzekutimit të vendimit për rikthimin e tij në punë, me pagën sipas pozicionit të punës”*.

Në këto rrethana, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon parimin e moslejimit të shqyrtimit nga institucionet e tjera, të çështjeve që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregulloren *“Mbi procedurat e*

mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 75, datë 29.06.2016, *“Mbi përfundimin e hetimit administrativ, filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 426/1 prot., datë 02.06.2016”*, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA